

**B U L E T I N I**  
**I S H K E N C A V E**  
**G J E O L O G J I K E**

**VITI VII (XXIV) I BOTIMIT**

**2**  
**1988**

**Tiranë**

## *Mineralet e dobishme*

# NDËRTIMI GJEOLGJO-STRUKTUROR DHE PERSPEKTIVA KROMBAJTËSE E ZONËS KRASTË-LUGU THELLË

Shadan Stërmasi\* [Jani Alabaku\*\*]

Jepet ecuria e mendimit gjeologjik në kërkim-zbulimin e vendburimit të kromit Krastë-Lugu Thellë, përshkruhen ndërtime gjeologjik, veçoritë e tektonikës shkëputëse, karakteristikat e trupave xeherorë të kromit dhe perspektiva e tyre.

### Shkëmbinjtë përbërës të zonës Krastë-Lugu Thellë

Vendburimi Krastë-Lugu Thellë ndodhet në pjesën jugperëndimore të zonës jugore të masivit ultrabazik të Bulqizës. Në ndërtimin gjeologjik të këtij vendburimi kromitik marrin pjesë këto lloje shkëmbore ultrabazike: Dunitet, harcбургitet, piroksenitet dhe serpentinitet (fig. 1).

*Dunitet* Shkëmbinjtë dunitike për vetë vëndin e tyre në profilin magmatik dhe sipas marrëdhënieve që ata kanë me shkëmbinjtë e tjerë ndahen në dy lloje:

a. Thjerza dunitike të ndërthurura me shkëmbinjtë harcбургitik duke formuar facien harcбургit-dunitike e deri dunitike-harcбургitike. Këta horizonte i përkasin facies tektonite. Petrografikisht përfaqësohen nga dunitet të serpentinizuar, ku minerali kryesor shkëmbformues është olivina e tipit forsteritik me 6-8% molekula fajaliti. Përveç olivinës vërehen kristale të rralla ortopirokseni tip enstatit me 4-6% molekula të ortoferosilitit. Pra, karakteristikat petrokimike të tyre janë të ngjashme me ato të harcбургiteve me të cilat ndërthuren. Shpesh në pjesët e sipërme të facies dunit-harcбургitike takohen dunitet intensivisht të serpentinizuara.

b. Dunitet e nivelit të sipërm, që përbëjnë pjesën e poshtme të sekuençës kumulate kanë përhapje relativisht të madhe në këtë zonë. Në aspektin strukturor kanë një vendosje me mospërputhje këndore me shkëmbinjtë harcбургitike. Në këto lloje shkëmbore lidhet mineralizimi kromitik i Krastë-Lugu i Thellë. Në përgjithësi paraqiten të serpentinizuara deri në shumë të serpentinizuar. Kanë ngjyrë gri të errët në

\*) Instituti St. Proj. të Gjeologjisë në Tiranë.

\*\*\*) Ndërmarrja Gjeologjike në Burrel.

rore nga veriperëndimi në juglindje, ndërsa zhvendosja e tyre në planin horizontal rezulton në drejtim të lindjes. Amplitudat e këtyre zhvendosjeve janë nga disa metra në 20-30 m, rrallë edhe më shumë.

## PËRFUNDIME

1. Vendburimi Krastë-Lugu i Thellë ndodhet në pjesën e poshtme, dunitike, të sekuencës kumulate. Në këtë pjesë të profilit magmatik përveç trupave dhe thjerzave kromitike që njihen deri më sot, priten trupa e thjerza të tjera kromitike më në gjërësi dhe më në thellësi.

2. Trupat xeherore janë singjenetik me shkëmbinjtë rrethues. Nga veprimtaria e tektonikave të pasmineralizimit, janë ndarë në blloqe me përmasa të ndryshme.

3. Në zonën Krastë-Lugu i Thellë rënia e dunitëve të sekuencës kumulate, e trupave xeherore që ajo përmban është verilindore, ndërsa rënia e dunit-harburgiteve dhe e harburgit-dunitëve, pra e sekuencës tektonite dhe e trupave kromitike, në të është jugperëndimore.

4. Daljet kromitike Krastë-Lugu i Thellë janë shfaqje erozionale të të njëjtit vendburim. Trupat e Lugut të Thellë janë nivele më të sipërme se sa ata të Krastës, kjo për pasojë gjenetike e jo për shkak tektonike. Në zonën e Lugut të Thellë duhet të kërkohet vijueshmëria e trupave të njohura të Krastës si dhe e trupave të tjera të pritsëm e të mundshëm mbi dhe nën këta.

5. Kërkimi i trupave xeherorë kromitike të sekuencës të pritshme dunit-harburgitike dhe harburgit-dunitike nën trashësinë e sekuencës kumulate paraqet interes. Për këtë duhen kryer shpime të thella strukturalo-kërkuese.

## LITERATURA

1. Alabaku J. etj. Raport gjeologjik i punimeve gjeologo-zbuluese të kryera në vendburimin kromifer të Krastës gjatë viteve 1958-1964, 1969-1975. Burrel, 1976.
2. Alabaku J. — Projekt i punimeve gjeologo-kërkuese e zbuluese në vendburimin e Krastës për vitin 1975. Burrel, 1976.
3. Canko S. — Raport gjeologjik i punimeve gjeologo-zbuluese të kryera gjatë viteve 1958-1982 në vendburimin kromifer Krastë-Lugu i Thellë. Burrel, 1963.
4. Çina A. — Mineralogjia e kromiteve të masivit ultrabazik të Bulqizës. Buletini Shkencave Gjeologjike. Nr. 3, 1987.
5. Dobi A. etj. Raport mbi studimet tematiko-përgjithësuese dhe kërkuese komplekse gjeologo-gjeofizike për prognozën krom-mbajtëse të masivit ultrabazik të Bulqizës për vitet 1978-1980. Tiranë, 1981.
6. Karkanaqe Xh. Qorlaze S. Projekt i punimeve gjeologo-zbuluese në vendburimet kromifer të Krastë-Lugu i Thellë për vitin 1969. Burrel, 1969.
7. Premti L, Stërmasi Sh. etj. Studim mbi «Hapjen dhe konkretizimin e perspektivës të mineralizimit të kromit të pasur në zonën perëndimore të vendburimit Batër. Tiranë, 1987.

8. Stërmasi Sh. etj. Raport gjeologjik i punimeve të kryera në v.b. kromifer të Krastës. Burrel, 1981.
9. Stërmasi Sh. Duni S. etj. Projekt studimi mbi intensifikimin e punimeve të kërkim zbulimit në masivin ultrabazik të Bulqizës në zonën e Matit. Burrel, 1981.

*Dorëzuar në redaksi në janar 1988*

### R é s u m é

#### **Structure et la perspective de la zone chromifère Krastë-Lugu i Thellë.**

Les gisements Krastë-Lugu i Thellë sont situés dans la partie au sud-ouest de la moitié sud du massif ultrabasique de Bulqiza. Dans la zone de ce gisement on trouve les types de roche suivants: harzburgites, dunités, pyroxénites et serpentinites.

La pensée géologique liée a la structure du gisement Kraste-Lugu i Thellë a évolué suivant les schémas dans la figure 1-6. Les corps chromitiques des niveaux supérieurs à cause de la montée génétique vers le nord-ouest sont réduits progressivement de haut en bas, alors que les corps inférieurs se rapprochent à la surface. Il en suit que les corps minéralisés de côtes supérieures ont une perspective limitée vers le nord ouest. Dans le plan sud ouest-nord est on peut attendre et rechercher d'autres lentilles chromifères au-dessus et en dessous de ceux qu'on connaît actuellement. En dessous de la partie inférieure dunitique de la séquence cumulate à pente vers le sud, donc en discordance angulaire, normalement se développe la séquence tectonite représentée par les harzburgites les harzburgites dunitiques et la minéralisation chromifère respective.

Fig. 1: Profil illustrant l'opinion suivant laquelle ce gisement est constitué de minéralisation chromitiques sous formes de lentilles.

Fig. 2: Profil qui représenta une minéralisation chromitique plissée.

Fig. 3: Profil où la structure minéralisée à la forme d'un anticlinal isométrique.

Fig. 4: et Fig. 5 Illustrant l'opinion actuelle suivant laquelle il s'agit de-corps minéralisés chromitiques superposés verticalement, accompagnés de lentilles chromifères entre ces mêmes corps.

Fig. 6: Coupe schématique illustrant l'opinion suivant laquelle dans le faciés dunitique cumulat de ce gisement les corps minéralisés sont caractérisés par des développements inégaux suivant des plans divers.

## LIGJËSITË E NDRYSHIMIT TË VETIVE KIMIKE SIPAS SHKALLËS SË QYMYRËZIMIT

Llazar Dimo\*, Polikron Vaso\*

Trajtohen ligjësitë e ndryshimit të parametrave kryesore kimike të qymyreve të disa vendburimeve të vendit tonë, sipas shkallës së qymyrzimit (ose rangut), duke i rekomanduar ato si kriter për kërkimin e qymyreve me cilësi më të mirë.

Një nga faktorët që ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e qymyreve dhe në vetitë teknologjike të tyre është shkalla e qymyrëzimit. Ajo përcakton ndryshimet që pëson lënda organike gjatë historisë së zhvillimit të saj, si rezultat i proceseve të ndryshme biokimike dhe fiziko-kimike.

Gjatë stadeve të ndryshme të qymyrëzimit mjaft prej parametrave kimike rriten ose zvogëlohen sipas rritjes së shkallës së qymyrzimit, siç është përmbajtja e karbonit, e lëndëve flurore, së fuqisë nxehëse, së lagështisë e të tjera. Për të studjuar këto varësi kemi analizuar për disa vendburime kimizmin e tyre simbas shtresave e vendburimeve, duke u mbështetur në analizat e paraqitura në disa studime (1, 2, 5, 6), e në raporte gjeologjike. Analizat janë kryer në laboratorin e ISPGJ dhe në laboratorët e ndërmarjeve gjeologjike.

Për të parë dinamikën e çdo parametri, krahasimin e kemi bërë me përmbajtjen e karbonit, i cili gjatë fazave të ndryshme të metamorfizmit pëson një rritje të doradorshme dhe në disa raste me prirje të kundërta me përmbajtjen e lëndëve fluturorese. Ndër parametrat që kemi marrë në analizë janë:

1 — *Lagështia* (W). Në qymyre dallojmë lagështinë e jashtme dhe lagështinë e brendshme (higroskopike). Lagështia e jashtme largohet në mjedisin e dhomës (temperatura 20°C në lagështi mjedisi  $65 \pm 5\%$ ). Lagështia e brendshme matet në laborator mbas largimit të lagështisë së jashtme dhe quhet analitike (W<sup>a</sup>).

Analizat e mesatarizuara (pasqyra 1), janë dhënë në grafikun e ndryshueshmërisë së përmbajtjes së lagështisë analitike (fig. 1). Lagështia është e lartë në qymyret që kanë përmbajtje të ulët karboni në masën e djegshme dhe shkallë të ulët qymyrzimi, siç janë qymyret e pëllgjeve pliocenike (Alarupi, Bezhani) dhe e ulët në qymyret me shkallë më të lartë qymyrëzimi siç janë vendburimet e pellgut të Korçë-Mokrës. Karakteristike në këtë grafik është përmbajtja mjaft e ulët e lagështisë (2-6%) në qymyret e pellgut të Korçë-Mokrës dhe përmbajtja e lartë (rreth 16%) në qymyret e Alarupit që i përkasin stadi të linjiteve mat.

\* Instituti i Studimeve dhe Projektimeve të Gjeologjisë në Tiranë

Vendburimi	Përmbajtja e acideve humike në lëndën qymyore pa ujë dhe pa hi në %
VB. Mborje Drenovë	Gjurmë
Homesh	0.12
Masmal	0.06
Pretushe	1.74—2.60
Dardhas	0.46—2.33
Krrabë—Mushqeta	2.22—8.35
Memaliaj	11.5—19
Mëze	16.—19 +
Valias	16.18
Manzë	18.43—20.69 +
Alarup	59.12—62.15 +
Bezhan	61.13—64.07

\*Analizat sipas H. Haxhiut (4)

### Përfundime

1. Vetitë kimike të qymyreve të vendit tonë ndryshojnë në përputhje me rritjen e shkallës së qymyrzimit.

2. Parametrat që pësojnë ndryshime edhe që shprehin qartë shkallën e qymyrzimit janë përmbajtja e lagështisë analitike, fuqia nxehëse në masën e lagët pa hi; përmbajtja e karbonit dhe përmbajtja e oksigjenit. Këta parametra duhet të jenë bazë për klasifikimin industrial e gjenetik të qymyreve për të bërë krahasimet me klasifikimet ndër-kombëtare dhe kombëtare.

3. Qymyret e vendburime të analizuara sipas shkallës së qymyrzimit, duke marrë për bazë edhe vetitë kimike, klasifikohen; 1. Linjite mat. (kryesisht qymyret pliocenike); 2-linjite të shkëlqyeshme (kryesisht qymyret e miocenit të mesëm); 3-linjite të shkëlqyeshme kalimtare për në qymyre guri (oligocenik i sipërm-miocenik i poshtëm); 4-qymyre guri (flakëgjatë deri gazor) qymyret e oligocenit të poshtëm.

4. Për kërkimin e qymyreve me cilësi më të mirë, punimet duhen përqëndruar në strukturën e Moraves, të Gore-Mokrës në suitën skutera të strukturës së Tiranës dhe në strukturën e Memaliajt.

### LITERATURA

- 1- Bibaja P., Hajnaj L etj. — Studim tematiko-përgjithësues mbi sfarimin e perspektivës për gjetjen e vendburimeve të qymyreve të koksifikueshëm. Tiranë, 1980.
- 2- Dimo Ll. Bibaja P., Shkupi D. etj. — Studim i perspektivës së vendit për qymyre të koksifikueshme dhe gjetjen e vendburimeve duke kryer dhe studime pasurimi. Tiranë, 1986.
- 3- Durmishi Ç — Analiza sedimentologjike dhe petrografike sekuenciale e formacioneve qymyrmbajtëse të Tepelenës. Tiranë, 1983.

- 4- Haxhiu H. — Disa të dhëna kimiko-fizike të qymyrit të vendit tonë që ndikojnë në përdorimin e tyre për prodhimin e koksit metalurgjik Bul. Shk. të Natyrës Nr.1, 1979.
- 5- Shkupi D, — Gjeologjia dhe qymyrbajtja e sinklinalit të Mokrës, Tiranë, 1983.
- 6- Ylli M., Osmani N etj. — Studim mbi metodikën e kërkimit dhe zbulimit të qymyreve të vendit tonë. Tiranë, 1980.
- 7- Vaso P — Analiza sekuenciale e vendburimit Drenovë dhe studim petrografik i shtresave të qymyrit. Tiranë, 1983.
- 8- Van Krevelen D. W., Seluyer I., Nauka ob uglje. Përkthim rusisht, Moskë, 1960.
- 9- Vaprosy metamorfizma uglei i epigenezisa vmeshajushih porod. Leningrad, 1968.

*Dorëzuar në redaksi në maj 1987.*

### R é s u m é

#### *Les variations des propriétés chimiques suivant le degré de carbonisation des charbons*

Dans cet article sont traitées les lois de variation des paramètres chimiques principaux des charbons de quelques gisements de notre pays suivant leur degré de carbonisation. Il en résultent les conclusions suivantes:

1. Les variations des paramètres principaux chimiques sont en concordance avec les variations du degré de carbonisations.

2. Les paramètres qui subissent les variations les plus importantes et en concordance avec le degré de carbonisation sont les suivants:

l'humidité analitique, la puissance calorifique de la masse humide sans cendres, la teneur du carbon (dans la masse à bruler), la teneur de l'oxygene (dans la masse à bruler). Ces paramètres peuvent servir pour déterminer le degré de carbonisation et la classification génétique des gisements de charbons (principalement des lignites) de notre pays.

Fig. : 1 La variation de l'humidié analitique.

Fig. : 3 La variation de la teneur en matières volatiles.

Fig. : 4 » » » » » » oxygène.

Fig. : 5 Le diagramme H/C et O/C.

## LIGJËSITË E NDRYSHIMIT TË VETIVE KIMIKE SIPAS SHKALLËS SË QYMYRËZIMIT

Llazar Dimo\*, Polikron Vaso\*

Trajtchen ligjësitë e ndryshimit të parametrave kryesore kimike të qymyreve të disa vendburimeve të vendit tonë, sipas shkallës së qymyrzimit (ose rangut), duke i rekomanduar ato si kriter për kërkimin e qymyreve me cilësi më të mirë.

Një nga faktorët që ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e qymyreve dhe në vetitë teknologjike të tyre është shkalla e qymyrëzimit. Ajo përcakton ndryshimet që pëson lënda organike gjatë historisë së zhvillimit të saj, si rezultat i proceseve të ndryshme biokimike dhe fiziko-kimike.

Gjatë staveve të ndryshme të qymyrëzimit mjaft prej parametrave kimike rriten ose zvogëlohen sipas rritjes së shkallës së qymyrzimit, siç është përmbajtja e karbonit, e lëndëve flurore, së fuqisë nxehëse, së lagështisë e të tjera. Për të studjuar këto varësi kemi analizuar për disa vendburime kimizmin e tyre simbas shtresave e vendburimeve, duke u mbështetur në analizat e paraqitura në disa studime (1, 2, 5, 6), e në raporte gjeologjike. Analizat janë kryer në laboratorin e ISPGJ dhe në laboratorët e ndërmarjeve gjeologjike.

Për të parë dinamikën e çdo parametri, krahasimin e kemi bërë me përmbajtjen e karbonit, i cili gjatë fazave të ndryshme të metamorfizmit pëson një rritje të doradorshme dhe në disa raste me prirje të kundërta me përmbajtjen e lëndëve fluturuese. Ndër parametrat që kemi marrë në analizë janë:

1 — *Lagështia* (W). Në qymyre dallojmë lagështinë e jashtme dhe lagështinë e brendshme (higroskopike). Lagështia e jashtme largohet në mjedisin e dhomës (temperatura 20°C në lagështi mjedisi  $65 \pm 5\%$ ). Lagështia e brendshme matet në laborator mbas largimit të lagështisë së jashtme dhe quhet analitike (W<sup>a</sup>).

Analizat e mesatarizuara (pasqyra 1), janë dhënë në grafikun e ndryshueshmërisë së përmbajtjes së lagështisë analitike (fig. 1). Lagështia është e lartë në qymyret që kanë përmbajtje të ulët karboni në masën e djegshme dhe shkallë të ulët qymyrzimi, siç janë qymyret e pëllgjeve pliocenike (Alarupi, Bezhani) dhe e ulët në qymyret me shkallë më të lartë qymyrëzimi siç janë vendburimet e pellgut të Korçë-Mokrës. Karakteristike në këtë grafik është përmbajtja mjaft e ulët e lagështisë (2-6%) në qymyret e pellgut të Korçë-Mokrës dhe përmbajtja e lartë (rreth 16%) në qymyret e Alarupit që i përkasin stadi të linjiteve mat.

\* Institut i Studimeve dhe Projektimeve të Gjeologjisë në Tiranë

## Vendburimi

Përmbajtja e acideve humike në lëndën qymyore pa ujë dhe pa hi në %

Vendburimi	Gjurmë
VB. Mbarje Drenovë	0.12
Homesh	0.06
Masmal	1.74—2.60
Pretushe	0.46—2.33
Dardhas	2.22—8.35
Krrabë—Mushqeta	11.5—19
Memaliaj	16.—19 +
Më zez	16.18
Valias	18.43—20.69 +
Manzë	59.12—62.15 +
Alarup	61.13—64.07
Bezhan	

\*Analizat sipas H. Haxhiut (4)

## Përfundime

1. Vetitë kimike të qymyreve të vendit tonë ndryshojnë në përputhje me rritjen e shkallës së qymyrmimit.

2. Parametrat që pësojnë ndryshime edhe që shprehin qartë shkallën e qymyrmimit janë përmbajtja e lagështisë analitike, fuqia nxehëse në masën e lagët pa hi; përmbajtja e karbonit dhe përmbajtja e oksigjenit. Këta parametra duhet të jenë bazë për klasifikimin industrial e gjenetik të qymyreve për të bërë krahasimet me klasifikimet ndërkombëtare dhe kombëtare.

3. Qymyret e vendburime të analizuara sipas shkallës së qymyrmimit, duke marrë për bazë edhe vetitë kimike, klasifikohen; 1. Linjite mat. (kryesisht qymyret pliocenike); 2-linjite të shkëlqyeshme (kryesisht qymyret e miocenit të mesëm); 3-linjite të shkëlqyeshme kalimtare për në qymyre guri (oligocenik i sipërm-miocenik i poshtëm); 4-qymyre guri (flakëgjatë deri gazor) qymyret e oligocenit të poshtëm.

4. Për kërkimin e qymyreve me cilësi më të mirë, punimet duhen përqëndruar në strukturën e Moraves, të Gore-Mokrës në suitën skutera të strukturës së Tiranës dhe në strukturën e Memaliajt.

## LITERATURA

- 1- Bibaja P., Hajnaj L etj. — Studim tematiko-përgjithësues mbi sqarimin e perspektivës për gjetjen e vendburimeve të qymyreve të koksifikueshëm. Tiranë, 1980.
- 2- Dimo Ll. Bibaja P., Shkupi D. etj. — Studim i perspektivës së vendit për qymyre të koksifikueshme dhe gjetjen e vendburimeve duke kryer dhe studime pasurimi. Tiranë, 1986.
- 3- Durmishi Ç — Analiza sedimentologjike dhe petrografike sekuenciale e formacioneve qymyrmbytëse të Tepelenës. Tiranë, 1983.

- 4- Haxhiu H. — Disa të dhëna kimiko-fizike të qymyrit të vendit tonë që ndikojnë në përdorimin e tyre për prodhimin e koksit metalurgjik Bul. Shk. të Natyrës Nr.1, 1979.
- 5- Shkupi D, — Gjeologjia dhe qymyrbajtja e sinklinalit të Mokrës, Tiranë, 1983.
- 6- Ylli M., Osmani N etj. — Studim mbi metodikën e kërkimit dhe zbulimit të qymyreve të vendit tonë. Tiranë, 1980.
- 7- Vaso P — Analiza sekuenciale e vendburimit Drenovë dhe studimi petrografik i shtresave të qymyrit. Tiranë, 1983.
- 8- Van Krevelen D. W., Schuyer I., Nauka ob uglje. Përkthim rusisht, Moskë, 1960.
- 9- Vaprosy metamorfizma ugljei i epigenezisa vmeshajushih porod. Leningrad, 1968.

*Dorëzuar në redaksi në maj 1987.*

#### *R é s u m é*

##### *Les variations des propriétés chimiques suivant le degré de carbonisation des charbons*

Dans cet article sont traitées les lois de variation des paramètres chimiques principaux des charbons de quelques gisements de notre pays suivant leur degré de carbonisation. Il en résultent les conclusions suivantes:

1. Les variations des paramètres principaux chimiques sont en concordance avec les variations du degré de carbonisations.

2. Les paramètres qui subissent les variations les plus importantes et en concordance avec le degré de carbonisation sont les suivants: l'humidité analytique, la puissance calorifique de la masse humide sans cendres, la teneur du carbon (dans la masse à brûler), la teneur de l'oxygène (dans la masse à brûler). Ces paramètres peuvent servir pour déterminer le degré de carbonisation et la classification génétique des gisements de charbons (principalement des lignites) de notre pays.

Fig. : 1 La variation de l'humidité analytique.

Fig. : 3 La variation de la teneur en matières volatiles.

Fig. : 4 » » » » » » oxygène.

Fig. : 5 Le diagramme H/C et O/C.

# MBI GJEOLGJINË DHE QYMYRBAJTJEN E KRAHUT PERËNDIMOR TË SINKLINALIT TË MOKRËS

Dëfrim Shkupi\*

Përshkruhen formacionet molasike që ndërtojnë krahun perëndimor të sinklinalit të Mokrës dhe qymyrbajtja e lidhur me to.

## H Y R J E

Në krahun perëndimor të sinklinalit të Mokrës janë zhvilluar më pak punime gjeologo-zbuluese se sa në krahun lindor të tij. Nga studimet e kryera nga autori dhe nga gjeologët e ndërmarrjes gjeologjike të Pogradecit kanë dalë në pah pak a shumë tiparet kryesore të formacioneve molasike e të shtresave qymyrore. Disa të dhëna e mendime të tjera paraqiten në këtë artikull të shkurtër.

## Stratigrafia

Si bazë për depozitimet molasike të krahut perëndimor të sinklinalit të Mokrës shërbejnë depozitimet e kretakut të poshtëm si dhe pjesërisht shkëmbinjtë ultrabazikë dhe depozitimet e kretakut të sipërm (2). Mbulesa molasike përfaqësohet nga depozitimet e oligocenit (rupelian-hatian) dhe të akuitanianit. Depozitimet eocenike në këtë krah mungojnë.

## Depozitimet oligocenike

Përfaqësohen nga konglomeratet dhe formacione qymyrbartëse. Konglomeratet dalin në afërsi të Llëngës e përfaqësohen nga zaje shkëmbinsh ultrabazikë me çimento ofiolitike dhe me zaje të rralla gëlqerorësh. Ato vendosen transgresivisht mbi gëlqerorët e kretakut të poshtëm. Mbi konglomeratet dhe mbi gëlqerorët e kretakut të poshtëm dhe

---

\*) I. S. P të Gjeologjisë në Tiranë.

## Përfundime

1. Në krahun perëndimor të sinklinalit të Mokrës janë ndeshur depozitimet oligocenike e akuitaniane. Konglomeratet e oligocenit kapen për herë të parë në Llëngë, ku duket qartë mospajtimi këndor i depozitimeve qymyrbajtëse oligocenike mbi to.

2. Ngulmohet përsëri për vendosjen transgresive të konglomerateve të Gurit të Kamies mbi depozitimet qymyrbajtëse të oligocenit pasi, si edhe krahun lindor të sinklinalit të Mokrës, ato mbulojnë disa shtresa qymyrore të kompleksit të sipërm qymyrbajtës.

3. Qymyrbajtja në krahun perëndimor të sinklinalit të Mokrës është e lidhur me depozitimet oligocenike (kompleksi i poshtëm dhe i sipërm qymyrbajtës), të njëllajta me ato të krahut lindor të sinklinalit të Mokrës. Nga punimet gjeologo-zbuluese të kryera është bërë lidhja dhe emërtimi më i saktë i shtresave qymyrore.

4. Gjatë kryerjes së punimeve gjeologo-zbuluese në depozitimet e kompleksit të poshtëm qymyrbajtës duhet të ndiqet dhe analogu i horizontit qymyror të Homesh-Jamës, që nuk del në sipërfaqe.

## L I T E R A T U R A

- 1- Dimo Ll. etj. — Studim tematiko përgjithësues për përcaktimin e prognozës qymyrbajtëse të strukturës Gorë-Mokër; Tiranë, 1980.
- 2- Harta Gjeologjike e R.P.S. e Shqipërisë. Shkallë 1:200000 Tiranë 1963.
- 3- Kadilli B., Shkupi D. — Raport mbi zbulimin e hollësishëm të vendburimit të qymyrit të Velçanit. Pogradec, 1981.
- 4- Pashko P. etj — Stratigrafia e depozitimeve paleogjenike dhe neogjenike të zonës së Mirditës. Tiranë, 1973.
- 5- Shkupi D. — Projekt mbi punimet e kërkimit në vb. e qymyreve Qafë Panjë. Pogradec, 1982.
- 6- Shkupi D. Dhima K. — Mbi vendosjen transgresive të serisë konglomeratike të Gurit të Kamies Bul. i Shken. Gjeol. Nr. 3, 1982.
- 7- Shkupi D. — Gjeologjia dhe qymyrbajtja e sinklinalit të Mokrës. Disertacion, Tiranë, 1983.
- 8- Shkupi D. Dhima K; — Gjeologjia dhe qymyrbajtja e krahut lindor të sinklinalit të Mokrës Bul. Shk. Gjeol. Nr. 3, 1984.

*(Dorëzuar në redaksi në nëntor 1987)*

## R é s u m é

### La géologie et la teneur en charbon du côté ouest du synclinal du Mokra

Les travaux et les études effectués sur le côté ouest du synclinal de Mokra ont mis en évidence le développement des dépôts oligocènes (du Rupélien Chatien) qui gisent transgressivement sur les dépôts calcaires du Crétacé inférieur et partiellement sur les roches ultrabasiques;

Ils sont couverts transgressivement aussi par les dépôts de l'Aquitaniens du Guri i Kames.

Les couches à charbon du complexe supérieur (analogues aux couches de Dardhasit et de Mokra) sont bien représentés et ont les mêmes indices que celles du côté orientale, alors que les couches du complexe inférieur ne montent pas totalement en surface.

L'horizont charbonifère analogue à celui de Homesh — Jamë peut être prospecté par des forages.

Fig. 1: La carte géologique schématique du côté ouest du synclinal de Mokra.

1 — Conglomérats; 2 — Grés. alevrolites. couches à charbon; 3 — Conglomérats (série conglomératique); 4 — calcaires; 5 — calcaires; 6 — roches ultrabasiqes; 7 — couche à charbon; 8 — limite transgressive.

Fig. 2: Coupe transversale du côté ouest du synclinal de Mokra.

1 — Dépôts d'Aquitaniens; 2 — dépôts oligocènes; 3 — roches ultrabasiqes; 4 — couche à charbon.

Fig. 3: Coupe transversale du gisement Velçan.

1 — Dépôts oligocènes; 2 — dépôts du Crétacé supérieur, 3 — couche à charbon.

## gjeokimi-mineralogji-petrografi

# DETALIZIME NË MËNYRËN E PARAQITJES DHE EMËRTIMIT TË KROMSHPINELIDEVE SIPAS PËRBËRJES KIMIKO-LËNDORE TË TYRE

Nezir Mekshiqi\*

Duke u bazuar në përbërjen kimike të kromshpinelideve të masivit ultrabazik të Tropojës dhe të masivëve të tjerë të vendit tonë, janë analizuar klasifikimet e njohura dhe janë bërë detализime në mënyrën e paraqitjes dhe emërtimit të kromshpinelideve. Diferencohen më qartë kufijtë e llojeve dhe të nënlojeve të kromshpinelideve duke i shprehur më mirë veçoritë e përbërjes kimiko-lëndore të kromshpinelideve të vendit tonë në tërësi.

Studimi mineralogjik, në gërshetim edhe me studimet e tjera, do të ndihmojë edhe në vlerësimin e krombajtjes të masivit ultrabazik të Tropojës, duke nxjerrë më në dukje praninë e disa horizonteve të mineralizimit të kromit, për orientimin e kërkimeve gjeologjike në tërësi në këtë masiv.

### **Analiza e klasifikimit dhe e mënyrave të përlogaritjeve të të dhënave të analizave kimike të kromshpinelideve.**

Me studimin e përbërjes dhe të klasifikimit të kromshpinelideve janë marrë shumë studiuës. Një analizë e hollësishme e klasifikimeve të njohura të kromshpinelideve dhe e mënyrave të përlogaritjeve të të dhënave të analizave kimike është dhënë në studimet e A. Çinës (1). Duke bërë përlogaritjet e të dhënave të analizave kimike të kromshpinelideve të masivit magmatik të Tropojës e masivëve të tjerë të vendit tonë dhe duke përdorur disa nga klasifikimet më të njohura të A. K. Bolldirjevit, N. V. Pavllovit, R. E. Stivensit, del se ato nuk shprehin në mënyrë të hollësishme kufijtë e llojeve dhe të nënlojeve për nëngrupet e kromshpinelideve.

Duke përdorur mënyrën e përlogaritjeve të të dhënave të analizave kimike, të shprehura në numrin e atomeve të elementëve që hyjnë në celulën elementare të kromshpinelideve dhe duke përdorur emërtimet e llojeve minerale sipas klasifikimit të A. K. Bolldirjevit, rezulton se kromshpinelidet xeherore të shumicës së vendburimeve dhe të shfaqjeve të mineralizuara të Tropojës, Kuksit, Bulqizës. Shebenikut janë të llojit magnokromit. Ato në përgjithësi karakterizohen nga për-

\* ) Ndërmarrja Gjeologjike në «Bajram Curri».

puthen me kromitet me përbërje hekurore dhe ato me vlera  $Mg/Fe^{+2} = 1.5-3$  që në përbërje përputhen me kromite magneziale, ku  $MgCr_2O_4 > FeCl_2O_4$ .

6. Duke nxjerrë karakteristikat kryesore të kromshpinelideve aksesore dhe xeherorformuese a, c, m, f në përqindje molekulare dhe karakteristikat dytësore a', c', m', f' del si rregullshmëri e përgjithshme se projektimi për karakteristikat kryesore me vlera të (c) rreth vijës horizontale (40) përputhet me kromshpinelide të pasur me (Al) dhe të varfër në krom, ndërsa projektimi tej vijës vertikale me vlera të f  $> 10$  përputhet me kromite hekurore, ndërsa tej vijës vertikale, me vlera të m  $> 20$  përputhet pa dyshim me kromite magneziale ku  $MgCl_2O_4 > FeCl_2O_4$ .

7. Duke ndërtuar diagramat me të dy metodat (për mundësi krahasimi) sipas raporteve atomike  $Mg/Fe^{+2}-Cr/Al$  dhe sipas karakteristikave kryesore a, c, m, f dhe dytësore a', c', m', f' del se paraqitja grafike dhe vetë emërtimi i përbërjes kimiko-lëndore të kromshpinelideve në diagramën  $Mg/Fe^{+2}-Cr/Al$ , që është përdorur nga ana jonë për deshifrimin e horizonteve kromitike të vendosura në pozicione të caktuara të profilit magmatik, është më shprehëse dhe më e thjeshtë.

#### LITERATURA

1. Çina A. — Mbi mineralogjinë dhe prejardhjen e kromshpinelideve. Tiranë, 1970.
2. Çina A. — Studim mineralogjik i vendburimeve të kromshpinelideve të masivit ultrabazik të Kam-Tropojës. Tiranë, 1966.
3. Çina A. — Disa të dhëna mineralogjike të xeherorëve e kromit të masivit ultrabazik të Bulqizës, Përmbledhje Studimesh, Tiranë, 1979.
4. Çina A. — Disa të dhëna mineralogjike të xeherorëve të kromit të masivit ultrabazik të Bulqizës, Tiranë, 1982.
5. Çina A. — Korelimi mineralogjik i kromiteve të pjesës jugore të masivit ultrabazik të Shebenik-Pogradecit. Bul. Shk. Gjeol. nr. 1, 1987.
6. Dede S. — Përbërja kimike dhe fenomenet izomorfizmit në mineralet e kromshpinelideve xeherorformues e aksesor të masivit ultrabazik të Bulqizës. Përmbledhje Studimesh, Nr. 3, Tiranë, 1973.
7. Dede S. — Përbërja lëndore e xeherorëve të kromit dhe kushtet gjenetike të formimit të vendburimit të Almarinës. Pëmb. Stud. Nr. 4, Tiranë, 1973.
8. Kiskyras A. D. — The chromites of the Island of Rhodes, A' contribution to the study of the Grek chromites for the chemical and geotectonic poivit of veim. Athens, October 9. 11. 1980.
9. Mekshiqi N. Haxhia Sh. — Projekt studimi mbi punimet e kërkim-zbullimit për zonën Kepenek-Qaf Prushi për vitin 1984. Bajram Curri, 1984.
10. Ostrosi B., Langora Ll., Tashko A., Mekshiqi N. etj — Metodat më racionale të kërkimit të xeherorëve të kromit në vendin tonë. — Referat mbajtur në konferencën kombëtare të gjeologjisë, Tiranë 1985.
11. Pavlov N. V. — Mestrozhdienia hroma, Rudnie mestorozhdienia SSSR. Tom. 1. Moskva, 1974.
12. Vranaj A. — Petrologjia dhe mineralmbajtja e shkëmbinjeve ultrabazikë të rajonit të Tropojës. Disertacion, Tiranë, 1984.
13. Zyka I., Dobi A., Mekshiqi N. — Raport mbi punimet tematiko-përgjithësuese për krombajtjen në zonën Kepenek-Zogaj, Qaf Prushi në masivin ultrabazik të Tropojës dhe orientimi i mëtejshëm i punimeve gjeologjike. Tiranë, 1976.
14. Zyka I., Hoxha S., Dobi A. — Raport mbi punimet tematiko-përgjithësuese të pjesës qëndrore dhe verilindore të masivit ultrabazik të Tropojës. Tiranë, 1978.

### R é s u m é

*Details de la présentation et de la nomination des chromespinelles selon leur composition chimique.*

On a déterminé les formules cristallographiques et le nombre atomique à partir d'environ 250 analyses chimiques des chromespinelles primaires et accessoires des massifs ultrabasiques de Tropoljė, Bulqizė, Shebenik-Pogradec, etc.

A partir des formules cristallographiques (fig. 4) on a déterminé les rapports atomiques ( $Mg/Fe^{2+}$ ) et ( $Cr/Al$ ). Suivant les valeurs limites de ces rapports atomiques on distingue six domaines:

1. Chromites ferrifères avec  $Mg/Fe^{2+} = 1.5$  et  $Cr/Al = 4-6$ .
2. Chromites magnésiales avec  $Mg/Fe^{2+} = 1.5-3$  et  $Cr/Al = 4-6$ .
3. Alumochromites ferreuses avec  $Mg/Fe^{2+} = 0-1.5$  et  $Cr/Al = 2-4$ .
4. Alumochromites magnésiales avec  $Mg/Fe^{2+} = 1.5-3$  et  $Cr/Al = 2-4$ .
5. Chromepicotites ferrifères avec  $Mg/Fe^{2+} = 0-1.5$  et  $Cr/Al = 0-2$ .
6. Chromepicotites magnésiales avec  $Mg/Fe^{2+} = 1.5-3$  et  $Cr/Al = 0-2$ .

Il en suit une représentation de la composition chimique en fonction de la disposition des chromites dans le profil magmatique selon les niveaux chromatiques de la minéralisation.

Il faut souligner le fait que les atomes de  $Fe^{3+}$  à l'intérieur du même corps minéralisé ou de même niveaux de minéralisation, varient irrégulièrement, sans relation définie dans le profil magmatique.

Ceci laisse à penser que les variations irrégulières de  $Fe^{3+}$  ne nous permettent pas directement ou non de différencier les niveaux de minéralisation le long du profil magmatique.

Si on réfère aux classements les plus connus des chromespinelles, il en suit qu'ils ont des limites très vastes et donc ne peuvent pas être utilisés pour faire la distinction entre les gisements qui se trouvent dans des horizons déterminés du profil magmatique.

Fig. 1a, 1b: Comportement de la composition chimique des chromespinelles des massifs Tropoljė, Kukės, Bulqizė, Shebenik et Urals (d'après le classement de R. E. Stevens).

Fig. 2: Comportement de la composition chimique des chromespinelles du massif ultrabasique de Tropoljė (Selon le classement de N. V. Pavlov).

Fig. 3: Comportement de la composition chimique des chromespinelles et leur classement en fonction des  $Mg/Fe^{2+}$ ,  $V_4Al$ ,  $Fe^{3+}$ ,  $Cl$  (% en poids).

Fig. 4: Comportement de la composition chimique des chromespinelles en fonction des valeurs limites des rapports atomiques  $Mg/Fe^{2+}$  et  $Cr/Al$ .

Fig. 5: Comportement de la composition chimique des chromespinelles en fonction des paramètres principaux  $a$ ,  $c$ ,  $m$ ,  $f$  et des paramètres secondaires  $a$ ,  $c$ ,  $m$ ,  $f$  pour le massif de Tropoljė etc.

1. Chromites podiformes localisées dans la sousformation harzburgite de la formation des tectonites ultrabasiques; le massif de Tropoljė.

2. Chromites podiformes localisées dans des enveloppes du dunites dans la sousformation des harzburgites; le massif de Tropoljė.

3. Chromites entre cumulates localisées en lentilles et en grands lits de dunités dans les parties supérieures de la formation des tectonites.

4. Chromites cumulates localisées en lentilles en lits massifs importants de dunités dans la formation (seris) des cumulates ultrabasiques.

5. Analyses chimiques de chromites: le massif de Kukës.

6.	»	»	»	»	Bulqizë.
7.	»	»	»	»	Shebenik.
8.	»	»	»	»	Pogradec.
9.	»	»	»	»	d'Oural
					Grèce

10. Chromites accessoires.

## VENDOSJA HAPËSINORE E PËRQËNDRIMEVE KROMIFERE NË PROFILIN E ULTRAMAFIKËVE NË VENDIN TONË

Injac Gj. Ndojaj\*

Analizohet pozicioni i përqëndrimeve kromifere në disa masivë ultrabazikë të vendit tonë. Mbështetur në vlerat e raportit Cr/Al; konkludohet se përqëndrimet kromifere të karakterit metalurgjik tektonit vendosen në një trashësi profilore 700-800 m duke u nisur nga kufiri midis sekuencave tektonite dhe kumulate. Brenda kësaj trashësie kumulate-tektonite veçohen katër horizonte përqëndrimesh kromifere. Bëhen krahasime me masivët ultrabazikë të Greqisë, Omanit, Turqisë. Qipros dhe Kaledonisë së Re.

1. Trashësia e ofioliteve ultramafike të brezit lindor të vendit tonë, ka qenë ndarë në dy pjesë: në të poshtmen, trashësia tektonite e përfaqësuar nga Iherzolit-hazburgite dhe dunitë, dhe në të sipërmen, trashësia kumulate e përfaqësuar nga dunit-dunitë piroksenite dhe dunitë plagjioklazike deri në troktolite. Kufiri në mes të dy trashësive jepet nga Moho petrologjike, ndërsa midis trashësisë kumulate ultramafike dhe gabroidëve që vazhdojnë përsipri, jepet Moho seizmike.

Përqëndrimet kromifere ndodhen në këto dy trashësi (fig. 1). Shpërndarja e tyre ndjek një rregull.

Në trashësinë kumulate kemi dy horizonte krommbajtëse: *përqëndrimet kromifere refraktare* (fill nën kufirin e Mohos seizmike ose nën dyshemenë e gabroideve) dhe *përqëndrimet kromifere metalurgjike* të vendosura nën horizontet e të parave, dhe fill mbi kufirin ndërmjet tektoniteve përposh dhe kumulateve përsipër. Të parat ndodhen në një mjedis dunit plagjioklazik-troktolit, ndërsa të dytat në një mjedis dunit-dunit-piroksenit.

Edhe në trashësinë tektonite kemi dy horizonte krommbajtëse: *përqëndrimet kromifere metalurgjike* dhe *përqëndrimet kromifere refraktare «mbetëse»*. Të parët ndodhen në një mjedis dunit, harzburgit me

---

\* Instituti i Studimeve dhe Projektive të Gjeologjisë në Tiranë.

platinoidëve, të sulfurave të nikelit, të tokave të rralla etj.

7. Përcaktimi i raportit Cr/Al vlen: për të caktuar vendosjen hapësinore vertikale të përqëndrimeve kromifere kundrejt njëri tjetrit dhe kundrejt kufirit kumulat i marrë konvencionalisht si niveli zero; për të vendosur në se dy a më shumë përqëndrime ndodhen në të njëjtin nivel ose në nivele të ndryshme; në se dy përqëndrime t'afërta janë pjesë e një trupi të vetëm i copëtuar nga procese tektonike apo janë përqëndrime të afuara tektonikisht dhe për të ndërtuar pozicionin struktural ë dy përqëndrimeve t'afërta ose të largëta.

8. Në përcaktimin e thellësive të vendosjes së përqëndrimeve kromifere, duhen marrë parasysh edhe kushtet tektonike mbasmineralizuese. Në bazë të gjeometrizimit struktural dhe të tektonikës rrudhosëse dhe çkëputëse, duhen ndërtuar trashësitë e sekuencave parësore dhe pas-taj duhet vlerësuar raporti Cr/Al për përcaktimin e thellësive të vendosjes së përqëndrimeve kromifere.

#### L I T E R A T U R A

1. **Caslli H. etj.** — Studim dhe përgjithësim i materialeve ekzistuese i strukturave të masivit ultrabazik të Kukësit, etj. Tiranë, 1968.
2. **Caslli H.** — Ndërtimi gjeostruktural i masivit të shkëmbinje ultrabazikë të Tropojës dhe përhapja e mineralizimit të kromit. Përmb. Stud. Nr. 7, Tiranë, 1968.
3. **Çina A., Mustafaraj M.** — Përbërja kimike e kromshpinelideve të disa vendburimeve dhe shfaqjeve të mineralizuara të masivit ultrabazik të Kam-Tropojës. Përmb. Stud. Nr. 4, Tiranë, 1966.
4. **Çina A.** — Të dhëna mineralogjike mbi xeherorët e kromit të masivit ultrabazik të Kukësit dhe mendime mbi gjenezën e tyre. Përmb. Stud. Nr. 3 (16) Tiranë, 1970.
5. **Çina A.** — Disa të dhëna mineralogjike të xeherorëve të kromit të masivit ultrabazik të Bulqizës për probleme të korelimit. Simp. mbi kromitet. Bulqizë, 1984.
6. **Çina A.** — Disa veçori fizike të kromshpinelideve xeherorë përbërës të masivit ultrabazik të Bulqizës. Bul. Shkenc. Gjeol. Nr. 4, 1985.
7. **Çina A.** — Korelimi i trupave xeherorë të kromit në bazë të mineralogjisë së kromshpinelideve. (Pjesa jugore e masivit ultrabazik Shebenik-Pogradec). Bul. Shk. Gjeol. Nr. 1, 1987.
8. **Dede S.** — Ndërtimi gjeologjik i masivit ultrabazik të Bulqizës dhe ligjësia e përhapjes së vendburimeve të kromit. Disertacion, 1960.
9. **Dobi A.** — Petrologjia e masivit ultrabazik të Bulqizës dhe vlerësimi i krommbajtjes. Disertacion. Tiranë, 1981.
10. **Goci L., Caslli H., Tërshana A.** — Ndërtimi gjeologjik i masivit të Kukësit Përmb. Stud. Nr. 9-10. Tiranë, 1981.
11. **Gjata K., Goci L.** — Tiparet petrologjike dhe metalogjenike të komplekseve magmatike të Mirditës verilindore. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 2, Tiranë, 1981.
12. **Gjokuta D., Sinoimeri A.** — Përbërja kimike e kromshpinelideve të disa shfaqjeve e objekteve të pjesës veriore të masivit të Shebenikut. Bul. Shk. Gjeol. Nr. 1, 1987.

13. **Lleshi B.** — Ndërtimi gjeologjik dhe perspektiva mineralmbajtëse e masivit ultrabazik të Lurës. Disertacion ISPGJ. Tiranë, 1983.
14. **Ndojaj I. Gj.** — Mbi gjeokiminë e përqëndrimeve kromifere të vendit tonë. Tiranë, 1986.
15. **Pine V., Tabaku Dh.** — Karakteristikat mineralogjike dhe përbërja lëndore e trupave xeherorë dhe e kromshpinelideve të masivit ultrabazik të Shebenikut. Përmb. Stud. Nr. 2, Tiranë, 1981.
16. **Premti I.** — Petrologjia dhe perspektiva krommbajtëse e shkëmbinjve ultrabazikë të vendburimit të Bulqizës. Disertacion. Tiranë, 1984.
17. **Vranaj A.** — Petrologjia dhe mineralmbajtja e shkëmbinjve magmatikë të rajonit të Tropojës. Disertacion. ISPGJ, Tiranë, 1984.
18. **Augé Th. (1982), Roberto Steph.** — Petrology and geochemistry of some chromitiferous bodies within the Oman Ophiolites. *Ophioliti* Vol. 7, nr. 2-3. Decembre, 1982.
19. **Herring R. S., Smith J. V., Steele J. M.** — Fertile and barriers Al-Cr from upper mantle: Ion and elektron probe analyses of trace elements in olivine and orthopyroxene; relation to lherzolite. *Earth and Planetary Letters Service*. 59 (49-58). 1980.
20. **Johan Z., Augé Th.** — Ophiolitic mantle sequenes and their evolution mineral chemistry constraints.
21. **Kornprobst J., Ndojaj I. Gj.** — Të dhëna kimike mbi disa shkëmbinj ultramafik të RPSSH. 1984.
22. **Leblanc M.** — Distribution of aluminium Rich and Chromium Rich Poda iu Ophiolitic Peridotites. *Econ. Geol.* Nr. 2 vol. 78. March-April, 1981.
23. **Moutte J.** — Les gisements de chromites du massif de Tiebagi et leurs cadres géologiques, Paris, 1979.
24. **Obradovic L.** — Mbi gjeokiminë e kromiteve të Brekovicës. R.F.G.J. 1986.

### R é s u m é

#### La disposition spatiale des concentrations chromifères dans le profil des ultramafiques des Albanides

Les ophiolites des Albanides sont représentées par deux ceintures de massifs à caractéristiques paléogéographiques, pétrologiques, métallogéniques totalement différentes. Les massifs ophiolitiques de la ceinture orientale sont les plus importants puisque ils contiennent les plus grandes concentrations chromifères.

Dans les séquences cumulates il existe deux horizons de concentrations: *les chromites de caractère refractaire* disposées juste sous le Moho séismique dans un milieu de dunites-dunites plagioclasiques et troctolites, et *les chromites de caractère métallurgique* disposées sur la base des cumulates juste sur le Moho pétrologique dans un milieu de dunites à dunites-pyroxènes. Dans les séquences tectonites, où se trouvent les concentrations les plus importantes se trouvent aussi deux horizons principaux de concentrations: *les chromites de caractère métallurgique* disposées sous le Moho pétrologique et qui vont environ 700-800 m en profondeur dans un milieu de dunites-harzburgites, et *les chromites de caractère refractaire «résiduelles»*, dans la profondeur des séquences tectonites dans un milieu de harzburgites à quelques pyroxènes monoclines et lherzolites-harburgites.

Parlant de l'idée qu'une concentration chromifère se forme dans des conditions physico-chimiques et de milieu strictement déterminées, l'auteur pense que le rapport Cr/Al est constant en tout point de la concentration et qu'il la reste même au cours de l'évolution de cette concentration.

Ce rapport varie en fonction de la disposition spatiale de la séquence dans laquelle est formée la concentration chromifère, vu que les conditions physico-

-chimiques de la formation des concentrations chromifères varient aussi selon leur disposition spatiale.

L'auteur met en évidence le fait que ce rapport dans les chromites métallurgiques vient en se diminuant à partir des concentrations les plus profondes des séquences tectonites.

Les concentrations chromifères métallurgiques tectonites se divisent en quelques horizons, lesquels à partir de la limite cumulate-tectonite (Moho pétrologique), vont jusqu'à environ 700-800 m.

L'auteur a utilisé des données sur la profondeur de la disposition des concentrations chromifères dans de divers pays du monde (cf. chimidiagramme).

Il a déterminé, pour chaque massif ultramafique de notre pays, quelques horizons de concentrations chromifères métallurgiques tectonites disposées en diverses profondeurs relatives.

L'auteur propose qu'un corps chromifère est situé au-dessus d'un autre corps si son rapport Cr/Al est inférieur à celui de l'autre.

De même, quand deux corps chromifères sont proches par leur position géologique ou tectonique, le rapport Cr/Al permet de dire si ils font part d'un même corps (même rapport Cr/Al), ou bien si ils sont deux corps différents approchés à cause des processus tectoniques (rapports Cr/Al différents). Selon l'auteur ce rapport aide aussi la recherche de la continuation d'une concentration chromifère fragmentée tectoniquement et déplacée dans divers niveaux de la même séquence ultramafique.

Fig. 1. Après Luteau, Th., Rahgoshau M., et modifiée)

1- Concentrations cumulées chromifères 2- Place de création des concentrations chromifères et leur déplacement frontière; 3- Concentrations chromifères métallurgiques tectonites: 4- Concentrations chromifères refractaires résiduelles tectonites.

Fig. 2. Chimidiagramme de massifs: 1- Shpati 2- Skënderbeu; 3- Krrabi; 4- Kukësi;

Fig. 3. Chimidiagramme de massifs: 1- Shpati; 2- Skënderbeu; 3- Krrabë-Pukë.

Fig. 4. Relations concordantes de dimensions de cellule élémentaire de chromite et rapport Cr/Al. Objects: 1- Stavec; 2- Cérruje; 3- M. Hurdhes; 4- Almerinë; 5- Lak Dervishit 6- Shkallë; 7- Thekën; 8- Q. Buall; 9- Krasta; 10- Vajkal.

Fig. 5. Relations discordantes proportionnelles de construction normative de shpinel  $MgAl_2O_4$  et rapport Cr/Al.

Fig. 6. Disposition spatiale de concentrations chromifères tectonites dans ultramafiques de ceinture orientale de notre pays.

Fig. 7. Disposition spatiale de concentrations chromifères métallurgiques de divers pays.

## TIPET DHE PRERJET E KOREVE LATERITORE TË XEHERORËVE TË HEKUR-NIKELIT DHE TË NIKELIT SILIKAT NË SHQIPËRI

Stavri Burri\*, Vaskë Pine\*\*, Perikli Jani\*\*\*.

Si rezultat i studimit të zonave të ndryshme të koreve të tjtërimit, përbërjes së tyre mineralogjike, si dhe vlerësimit të faktorëve gjeokimikë, japim prerjet e koreve të tjetërimit, tipet dhe zonalitetin e tyre. Këto të dhëna japin mundësi për një njohje edhe më të thellë të vendburimeve të hekur-nikelit dhe të nikelit silikat në vendin tonë dhe ndihmojnë shumë në kërkim-zbulimin e vendburimeve të pasura të hekur-nikelit dhe nikelit-silikat.

Në disa masive të brezit lindor të shkëmbinjve ultrabazikë të vendit tonë është formuar një kore e vjetër tjetërimi lateritore, ku janë takuar dy tipe kryesore xeherore, ai i hekur-nikelit, në pjesët më të sipërme dhe ai i nikelit silikat, në pjesët më të poshtme si edhe serpentinitet nikelore, akoma më poshtë. që mund të përbëjnë në të ardhmen një tip të tretë xeherori.

Studimi i veçorive të ndërtimit dhe të përbërjes së këtyre xeherorëve dha mundësinë e kuptimit më të mirë të zhvillimit të kores së tjetërimit, të njohjes së tipeve të prerjeve që takohen në vende të ndryshme si dhe të zhvillimit të tyre në pikëpamje morfologjike. Për formimin e zonave të ndryshme të kores laterite kanë ndikuar disa faktorë bashkarisht, si përbërja e shkëmbinjve mëmë, relievi i vjetër, agjentët e tjetërimit etj.

### 1. Të përgjithshme

Me proceset e tjetërimit të shkëmbinjve të ndryshëm janë të lidhura formimet e shumë vendburimeve të mineraleve të dobishme. Tjetërimi është një proces gjeologjik krahinor, që zhvillohet në kushte kontinentale dhe përfshin komplekse të shumë llojshme shkëmbinjsh, që janë

\* Fakulteti i Gjeologjisë dhe i minerave në U. T. «Enver Hoxha».

\*\* Ndërmarrja Minerare «Guri i kuq» në Pogradec.

\*\*\* Ndërmarrja Gjeologjike në Korçë.

3. Përcaktimi i drejtë i zonave të tjetërimit na jep mundësi të emërtojmë drejtë tipet e prerjeve, gjë që ndihmon shumë në kërkim-zbulimin e vendburimeve me xeheror të pasur hekur-nikeli dhe nikeli silikat.

4. Duhet bërë studime më të plota, në të gjithë sheshet ku shtrihet kora e tjetërimit, për të përcaktuar tipet e prerjeve, kushtet paleogjeografike të formimit të tyre dhe tipet xeherore, për vlerësimin më të plotë të formimit dhe ruajtjes së tyre dhe për kërkim më me sukses të vendburimeve të tjera.

## L I T E R A T U R A

1. Burri S. — Kora e vjetër e tjetërimit të shkëmbinjve ultrabazikë në rajonin e Bilishtit të rrethit të Korçës. Përmbledhje Studimesh, Nr. 1, Tiranë, 1982.
2. Burri S. — Përbërja minerale e xeherorëve të hekur-nikelit dhe të nikelit silikat të vendburimit të Bit. të Rrethit të Korçës. Përmbledhje Studimesh, Tirane, 1984.
3. Burri S. — Përbërja minerale e xeherorëve të hekur-nikelit të rajonit të Pogradecit. Përmbledhje Studimesh, Tiranë, 1988.
4. Bushi E. — Kushtet e formimit dhe zhvillimi paleogjeografik i prodhimeve të kores së prishjes në rajonin e Kukësit. Përmbledhje Studimesh, Nr. 2, Tiranë 1977.
5. Gjokuta D. — Mineralogjia dhe kimizmi i kores parësore dhe dytësore të tjetërimit në rajonin e Kukësit. Përmbledhje Studimesh, Nr. 3, Tiranë, 1980.
6. Jani P., Gruçka F. — Raport gjeologjik për vendburimet e hekur-nikelit dhe të nikelit silikat në Bit. Korçë. 1978.
7. Janku I., Pine V., Nanushi K. — Raport mbi punimet e zbulimit të kryer në vitet 1963-1980 në vendburimin e hekur-nikelit Çervenakë Perëndimore. Pogradec, 1981.
8. Molla I. — Të dhëna të reja për gjeologjinë dhe veçoritë e ndodhjes së prodhimeve të kores së tjetërimit në rajonin Skroskë-Katiel. Buletini i Shkencave Gjeologjike Nr. 1, Tiranë, 1985.
9. Noka H. — Premisat kryesore të kërkimit të mineraleve të nikelit silikat të pasur në rrethin e Kukësit. Përmbledhje Studimesh, Nr. 8, Tiranë. 1968.
10. Noka H. — Mbi kufirin midis kores parësore dhe kores dytësore të prishjes në rrethin e Kukësit. Përmbledhje Studimesh Nr. 1, Tiranë, 1985.
